



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 121

Prishtinë, më 15.7.2013, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Daut Haradinaj.

Mungoi : Boban Todorović, Liburn Aliu, Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 8.7.2013,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratet mjedisore,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtesat në bashkëpronësi,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.7.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 8.7.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektorate

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit nga MMPH dhe bashkërisht me anëtarët prezent u miratuan amendamentet si në vijim :

Amendamenti 1

Neni 3, pas **Nënparagrafit 1.1** shtohet një nënparagraf i ri :

Mbikëqyrje administrative- është kontrollë dhe mbikëqyrje për zbatimin e ligjit dhe akteve tjera me qëllim të parandalimit, zvogëlimit dhe mënjanim të parregullsive në zbatimin e ligjit dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Nënparagrafi 1.2, riformulohet si në vijim:

“Procedura inspektuese- Përgatitja, vizita në terren, konstatimi dhe marrja e masave”

Nënparagrafi 1.4. fjala **“organin”** bëhet **“organ”**.

Nënparagrafi 1.17. riformulohet si vijon :

Inspektorati i Ministrisë- Inspektorati i Mjedisit, Natyrës, Ujrave dhe Inspektorati i ndërtimit dhe Planifikimit hapësinor;”

Amendamenti 2

Neni 4, Paragrafi 2 riformulohet si vijon: **“Inspektorati i Ministrisë udhëheqet nga Drejtori i cili për punën e tij dhe të inspektoratit i përgjigjet Sekretarit të përgjithshëm dhe Ministrit.”**

Amendamenti 3

Neni 7, Nënparagrafi 1.6. riformulohet si vijon :

Siguron përparimin e punës dhe ngritjen profesionale të inspektorëve përmes trajnimeve profesionale për inspektorët e Ministrisë dhe inspektorëve komunal.

Nënparagrafi 1.8, fshihet

Amendamenti 4

Neni 10 , riformulohet si vijon :

Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit

1. Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit ushtron mbikëqyrjen inspektive dhe kontrollë përmes inspektimit mjedisor në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së mjedisit.

2. Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit, ushtron detyrat dhe përgjegjësit e tij në mbrojtje të mjedisit, duke harmonizuar aktivitetin e tij me Rekomandimet e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për “Kriteret Minimale për Inspektimet Mjedisore në Shtetet Anëtare” (RMCEI 2001/331/EC).

Amendamenti 5

Neni 11, riformulohet si vijon :

Inspektorati i Mbrojtjes së Natyrës1. Inspektorati i mbrojtjes së natyrës ushtron mbikëqyrje inspektive dhe kontrollë përmes inspektimit në natyrë në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës.

2. Inspektorati për mbrojtjen e natyrës, ushtron detyrat dhe përgjegjësit e tij në mbrojtje të natyrës, duke harmonizuar aktivitetin e tij me kërkesat e Bashkimit Evropian, për rrjetin “NATURA - 2000”.

Amendamenti 6

Neni 12, riformulohet si vijon :

Inspektorati i ujërave

Inspektorati i ujërave ushtron mbikëqyrje inspektive dhe kontrollë përmes inspektimit të ujërave në zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ujërave.

Amendamenti 7

Neni 13, riformulohet si vijon:

Inspektorati i urbanizmit

Inspektorati i urbanizmit ushtron mbikëqyrje administrative dhe kontrollë përmes inspektimit urbanistik në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.”

Amendamenti 8

Neni 14, riformulohet si vijon :

Inspektorati i ndërtimit

Inspektorati i ndërtimit ushtron mbikëqyrje inspektive dhe kontrollë përmes inspektimit ndërtimor në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fushën e ndërtimit”.

Amendamenti 9

Neni 15, paragrafi 1, “ është i organizuar” zëvendësohet me “ “organizohet”.

Amendamenti 10

Neni 18, riformulohet si vijon :

Kriteret për zgjedhje

1. Në vendin e punës kryeinspektor dhe inspektor të inspektoriatit të ministrisë mund të caktohet inxhinier i diplomuar i profileve të fushave përkatese dhe në harmoni me ligjet tjera në fuqi që rregullojnë fushën e administratës shtetërore dhe shërbyesve civil.

2. Kryeinspektori dhe inspektori zgjidhen sipas konkursit publik në pajtim me dispozitat përkatese në fuqi në Republikën e Kosovës.

Amendamenti 11

Neni 19, Nënparagrafi 1.6 riformulohet si vijon :

Pa përgjegjësi dhe në mënyrë joprofesionale kryen mbikëqyrjen inspektuese dhe detyrat tjera të punës, dhe; “

Amendamenti 12

Neni 20, paragrafi 1, fjala “inspektorin” zëvendësohet me “inspektoratin”.

Paragrafi 3, riformulohet :

Për shkak të specifikave të natyrës së punës, ndërlikueshmërisë dhe rrezikut për jetë, Inspektori gjatë ushtrimit të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, kompensohet sipas Ligjit të Shërbyesve Civil”.

Fshihet Paragrafi 4.

Amendamenti 13

Fshihet neni 21, dhe bëhet rinumërimi i neneve.

Amendamenti 14

Kreu VII , riformulohet titulli i Kreut : **BUXHETI I INSPEKTORIATIT.**

Neni 22 , riformulohet si vijon :

Buxheti

1. Inspektorati e ka buxhetin e vet, i cili është në kuadër të Ministrisë.

2. Kryeinspektori përgatitë dhe dorëzon planin për buxhetin vjetor të Inspektoratit për procedim të mëtejshëm.

3. Përgjegjësin për menaxhimin, përdorimin dhe shpenzimin e buxhetit të inspektoratit e ka Kryeinspektori.

4. Kryeinspektori sipas nevojave i propozon Ministrit buxhet shtesë për nevojat e Inspektoratit.

5. Të hyrat nga gjobat derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 15

Fshihet Neni 23.

Amendamenti 16

Neni 25, Nënparagrafi 1.1. në fund pas fjalës “ligjet” shtohet “të tjera” në fuqi.

Amendamenti 17

Neni 26 , Nënparagrafi 1.3. fshihet.

Nënparagrafi 1.5. në fillim fshihet fjala “përkohësisht”.

Amendamenti 18

Neni 33 , Nënparagrafi 1.1. fjala “jo e lajmëruar” zëvendësohet me “paparalajmëruar”.

Amendamenti 19

Neni 35, riformulohet si në vijim:

Inspektorati i Ministrisë bashkëpunon me institucionet relevante shtetërore, organet komunale, policinë, gjyqësorin, prokurorinë, doganën, inspektoratet e fushave perkatese dhe institucionet relevante.

Amendamenti 20

Neni 38, Paragrafi 5, në fillim pas fjalës “mbikëqyrjes” shtohet “nga paragrafi 3 i këtij Neni” dhe vazhdon teksti si në paragraf të Projektligjit.

Paragrafi 10, fjala “Ministri” zëvendësohet me “Ministria”.

Amendamenti 21

Neni 42, paragrafi 3, “mund të shqiptojë” zëvendësohet me “shqipton”.

Amendamenti 22

Neni 43

Paragrafi 1, “pesëmbëdhjetë (15)” zëvendësohet me “tetë (8)”.

Paragrafi 2, “30” zëvendësohet me “pesëmbëdhjetë (15)”.

Paragrafi 3, “pesëmbëdhjetë (15)” zëvendësohet me “tetë (8)”.

Paragrafi 4, pas fjalës “Ministrisë” shtohet “në afat prej(8) ditësh” dhe vazhdon teksti.

Paragrafi 5, “30” zëvendësohet me “pesëmbëdhjetë (15)”.

Amendamenti 23

Neni 44, paragrafi 2, fjala “Ministri” zëvendësohet me “Ministria”.

Amendamenti 24

Neni 45, Paragrafi 2, “rocedurat“ zëvendësohet me “procedurat” dhe fjala “Ministri” zëvendësohet me “Ministria”.

Amendamenti 25

Neni 46, në titull fshihet “i përkohshëm” dhe fjala “Ministri” në paragrafin 2 zëvendësohet me “Ministria”.

Amendamenti 26

Neni 48, paragrafi 2 riformulohet si vijon :

Formën dhe përmbajtjen e formularit për ndëshkim me gjobë mandatore e përcakton Ministria kurse për njësitë e administrimit lokal, autoriteti komunal.

Amendamenti 27

Neni 50, nënparagrafi 2.5 fshihet.

Amendamenti 28

Neni 52, paragrafi 2, riformulohet si vijon :

2. Me gjobë në të holla prej pesëmijë (5000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik kurse pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) Euro personi përgjegjës i personit juridik në organin kompetent në nivel qendror dhe lokal, Neni 24, paragrafi 1.2. i këtij Ligji.

Paragrafi 3 riformulohet si vijon :

3. Me gjobë në të holla prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik dhe pesëqind (500) deri në njëmijë (1000) Euro personi përgjegjës në nivel lokal, Neni 24 paragrafi 1.3. i këtij Ligji.

Amendamenti 29

Neni 55, fshihet.

Amendamenti 30

Neni 56, “një (1) viti” zëvendësohet me “gjashtë (6) muaj”.

Pasi që u miratuan amendamentet, **Daut Haradinaj** kërkoi edhe disa sqarime nga zyrtaret Florije Kqiku dhe Shkendije Ballata rreth inspektimeve që do të bëhen sidomos pasi të hyj ky ligj në fuqi.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtesat në bashkëpronësi

Lidhur me këtë projektligj **Kryetari Nait Hasani**, sipas sugjerimeve nga stafi, njoftoi se janë bërë disa lëvizje teknike të amendamenteve, pasi është kërkuar në rekomandimin e Komisionit për legjislacion, ndërkaq në amendamentin e fundit u ndryshua afati te pika 2.1 në gjashtë muaj sa i përket nenit 49. Rekomandimi sipas votimit unanim të Komisionit ishte që projekti të shkoi në leximin e dytë , mbledhjes plenare.

5. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme deputeti **Daut Haradinaj** kërkoj sqarim për Nenin 5 të Ligjit për parkun Bjeshkët e Nemuna, ndërsa kryetari **Nait Hasani** sqaroi se me këtë Nen hiqen dilemat rreth rrezikimit të drejtës së pronës, ngase prona private rregullohet me dy Ligje tjera që do të iniciohen në vijim, pronarët privat duhet të presin Ligjin për Pronën dhe Ligjin për Denacionalizim.

Mbledhja përfundoi në orën 11,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani